



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Pridato Received/Delivered	11.01.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMBHCK	84/2021		119



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.374/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.374/2020 të datës 26.11.2020 të parashtruar nga [REDACTED] me adresë banimi Rr."Ahmet Krasniqi" nr.208, Prishtinë, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.01.2021, mori këtë;

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.374/2020 e datës 26.11.2020, e parashtruar nga ankuesi, [REDACTED].
- II. ANULOHET Masa disiplinore "Vërejtje për dosje personale" me numër protokollit 2020/ZDP/311 e datës 18.11.2020 e shqiptuar ndaj ankuesit, [REDACTED].
- III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

Arsyetim

[REDACTED], Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 26.11.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2767/2020 e regjistruar me numër A.nr.374/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje për dosjen personale" me numër protokollit 2020/ZDP/311 të datës 18.11.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 30.11.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Këshilli më datë 10.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2767 të datës 26.11.2020 e regjistruar me numër A.nr.374/2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 25.11.2020 të dërguar nga A.D: Masën disiplinore të vërejtjes, me numër të protokollit 2020/ZDP/311 të datës 18.11.2020 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së; E-mailin e datës 29.09.2020 të dërguar nga S.K për A.D: E-mailin e datës 28.09.2020 të dërguar nga B.E për S.K: E-mailin e datës 25.09.2020 të dërguar nga S.K për B.E: Procesin e Menaxhimit të Raporteve të Ndodhive (RN) të datës 19.10.2020: E-mailin e datës 25.09.2020 të dërguar nga M.RR; E-mailin e datës 21.10.2020 të dërguar nga B.GJ për A.D: Përshkrimin e Procesit të Menaxhimit të Raporteve të Ndodhive (RN); Faturën e datës 03.11.2020 nr.329: Tabelën shpjeguese me numër NR.5/2020: Planin për Menaxhimin e Kontratës të datës 29.09.2020: E-mailin e datës 26.10.2020 të dërguar nga N.Sh, Prestige për A.D: Kërkesën për përkthim të dokumentit zyrtar të datës 21.10.2020; E-mailin e datës 21.10.2020: E-mailin e datës 26.10.2020: Kërkesën për përkthim të dokumentit të datës 21.10.2020: Emailin e datës 25.11.2020 të dërguar nga L.K për A.D: Emailin e datës 25.11.2020 të dërguar nga A.D për L.K; Emailin e datës 29.09.2020 të dërguar nga GJ.B për L.K: Emailin e datës 29.09.2020 të dërguar nga L.K për B.E dhe GJ.B; Emailin e datës 29.07.2020 nga L.K për CAA.staff: Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.11.2020 me numër të protokollit 2848/2020: Përgjigja në ankesë të datës 10.12.2020 me numër të protokollit 3076/2020: Akt Emërimit të datës 30.04.2013: Emailin e datës 09.12.2020: Emailin e datës 29.07.2020: Përshkrimi i procesit lidhur me përkthimin e shkresave të CAA 20.12.2018.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, të dorëzuara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Akt Emërimit të datës 30.04.2013, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar pranë Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik, në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës. Ankuesi përmes e-mailit zyrtar të datës 28.09.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së është caktuar Menaxher i Kontratës për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Përkthimit".

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, me datë 18.11.2020, përmes shkresës me numër protokollit 2020/ZDP/311, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje për dosje personale" me arsyetimin se ankuesi në cilësinë e menaxherit të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Përkthimit", me datë 21.10.2020 përmes e-mailit ka pranuar kërkesë nga Departamenti për Siguri dhe Cilësi, për përkthimin e dokumentit "Procesi për menaxhimin e

OR-ve" dhe përkundër se kërkesa ka qenë e refuzuar nga Drejtori i Përgjithshëm, ankuesi të njëjtën e ka përcjell për përkthim të Kompania Përgjegjëse, duke bërë kështu shkelje të rregullave dhe parimeve të etikës së punës, ku kërkohet nga secili nëpunës civil që t'i kryej detyrat e punës në mënyrë të drejtë dhe efikase.

Ankuesi, në ankesën e dorëzuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk ka qenë i njoftuar se kërkesa e njësisë kërkuese për përkthimin e dokumentit "Procesi për menaxhimin e OR-ve" është refuzuar nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe konsideron se masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtares Publike.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se me datë 21.10.2020, [REDAKTUAR] Inspektor në Departamentin e Sigurisë dhe Cilësisë pran AAC-së, ka dërguar e-mail në adresë elektronike të ankuesit, me përshkrimin: *Është kërkuar nga ZDP-ja që të përkthehet në shqip Procesi për menaxhimin e OR-ve, kështu që po ta dërgoj të bashkangjitur procesin për përcjellje të firma e përkthimeve.* Ankuesi, të njëjtën ditë, përmes e-mailit të datës 21.10.2020, dokumentin e njësisë kërkuese e ka përcjell për përkthim të kompania përgjegjëse N.Sh, Prestige.

Kolegji, po ashtu, në shkresat e lëndës ka gjetur se pas shqiptimit të masës disiplinore, ankuesi përmes e-mailit zyrtar me datë 25.11.2020, i është drejtuar Udhëheqëses së Departamentit për Siguri dhe Cilësi, me kërkesë që të njoftohet nëse kërkesa e datës 21.10.2020 për përkthim të dokumentit "Procesi për menaxhimin e OR-ve" ka qenë e refuzuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtoresha e Departamentit për Siguri dhe Cilësi, me datë 25.11.2020, përmes e-mailit ka njoftuar ankuesin se nuk kanë pranuar me shkrim ndonjë shkresë lidhur me refuzimin e kërkesës.

Andaj, duke u bazuar në e-mailin e datës 21.10.2020, të dërguar në emër të njësisë kërkuese nga [REDAKTUAR], në adresë elektronike të ankuesit, ku thuhet se është kërkuar nga Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm që të përkthehet në shqip "Procesi për menaxhimin e OR-ve", si dhe duke marr parasysh se në dosjen e lëndës nuk ka një shkresë tjetër që dëshmon se ankuesi ka qenë i njoftuar për refuzimin e kërkesës të njësisë kërkuese, Kolegji vlerëson se Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së me rastin e konstatimit të përgjegjësisë dhe shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtares Publik, përkatësisht neni 45, ku përcakton se: *1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës; 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.* Pra, Kolegji konsideron se organi i punësimit me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë se ankuesi ka qenë i njoftuar me shkrim se kërkesa e njësisë kërkuese për përkthim të dokumentit ka qenë e refuzuar, dhe se ankuesi me fajin e tij ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, për me tepër Drejtori i Përgjithshëm i AAC-se, nuk e ka marr për bazë si fakt vendimtar e-mailin e datës 21.10.2020 të dërguar nga [REDAKTUAR], në adresë elektronike të ankuesit, ku thuhet se: *Është kërkuar nga ZDP-ja që të përkthehet në shqip*

Procesi për menaxhimin e OR-ve, andaj në këtë kuptim, Kolegji konsideron se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: "Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës", ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: "Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit".

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.374/2020

Ilire Mehmeti-Shaqiri

~~Procesmbajtëse~~

Jeton Koca
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit: ██████████;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.